



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

Shtojca 11.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

[Data 16.01.2025]

Drejtuar: Vojsava Zenelaj P.F., Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dytë ne baze te vendimit te **KPP nr.24/2026** date 07.01.2026 prot me tonen nr.69/1 date 09.01.2026

Operatorit Ekonomik (OE) ☐ ose

[Vojsava Zenelaj P.F., me Nipt:L12330004A dhe Adresa: Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dytë]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) ☐ **Nuk eshte bashkim operatoresh**

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** **X**

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedure e Hapur mbi kufirin e larte monetar, Marreveshje Kuader**

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **[REF-50466-06-09-2025 “UNIFORMA”** Per nevojat e shoqerise Illyrian Guard SH.A ,MK kohezgjatja 12 muaj]

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 09.06.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike [Buletini Nr. 31 datë 16 Qershor 2025]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomiksht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Arisa Konfeksion Sh.p.k

me Nipt: J61828068L

Vlera (132,345,000 Njeqind e tridhjetë e dy milion e treqind e dyzete e pese mije Leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐

JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2.BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k me NIPT:K81324039M dhe NIPT K71821009N

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera (98,430,000 Nentedhjetë e tete milion e katerqind e tridhjetë mije leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. Vojsava Zenelaj P.F.

me NIPT:L12330004A

Vlera (138,720,000 Njeqind e tridhjetë e tete milion e shtateqind e njezete mije leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO X

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Etj. _____

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Arisa Konfeksion Sh.p.k

Nipt: J61828068L

Vlera (132,345,000 Njeqind e tridhjetë e dy milion e treqind e dyzete e pese mije Leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO x

Arsyet e Skualifikimit:

Ne baze te vendimit nr.1702/2025 te KPP me nr prot,2645/11, date 18.11.2025

Prot me tonen me nr,187/101, date 21.11.2025 - Faza: Kriter i pergjithshem

Sipas rivlersimit date 30.12.2025 me nr prot 187/112- kësaj kohe, KVO u njoh me disa pretendime të cilat u vlerësua se duhej të trajtoheshin me përgjegjësi, në funksion të vlerësimit të drejtë të ofertave të paraqitura. Këto pretendime u paraqitën nga një shoqëri e deklaruar si prodhuese nga një prej ofertuesve të kësaj procedure, konkretisht shoqëria ISMONT TEKSTILE PRODUCTION and MARKETING CO si prodhues i artikujve të ofruar nga operatori ekonomik Vojsava Zenelaj p.f., me NUIS L12330004A,, me e-mailin e datës 25/11/2025, ku pretendohet se kërkon që, përpara marrjes së një vendimi përfundimtar lidhur me dokumentacionin e paraqitur në ofertat, të verifikohen me përgjegjësi autenticitetin dhe përmbajtjen e dokumenteve të paraqitura nga ofertuesit për përmbushjen e kërkesave për raportet e testimit, duke kryer një verifikim të detajuar për të dy laboratorët (Azolab Laboratuvar Hizmetleri A.Ş. në të cilin Arisa Konfeksion mund të ketë kryer analizat përkatëse)

Lidhur me sa më sipër, në funksion të vlerësimit sa më të drejtë dhe objektiv të ofertave të paraqitura, KVO vendosi që të rivlerësojë ofertat e paraqitura nga të dy ofertuesit ankues, duke i kualifikuar ata për konstatimet e bëra në vendimin e KPP nr. 1702/2025, por përpara se të mbyllte vlerësimin vendosi të bëjë edhe verifikimet si vijon:

Nga indicia e administruar nga KVO me datë 25/11/2025, si dhe nga shqyrtimi teknik i normave të analizave të paraqitura nga “Arisa Konfeksion” shpk, KVO ka konstatuar mospërputhje dhe elementë të dyshimtë në rezultatet e raportuara, të cilat krijojnë dyshime të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe korrektësinë e tyre të cilat do t’gjeni bashkëlidhur. u krijua dyshimi i arsyeshëm mbi vërtetësinë e dokumentacionit teknik të paraqitur. Në këto kushte, me qëllim verifikimin e saktësisë dhe autenticitetit të dokumenteve përkatëse, KVO kërkoi konfirmimin e vërtetësisë së tyre pranë subjekteve përkatëse.

Me anë të postës elektronike, kërkoi nga laboratorët të cilët kanë lëshuar test raportet për të dy shoqëritë, të deklaronin vërtetësinë e raport analizave të paraqitura në procedurë. Konkretisht kërkesat u bënë në adresat e postës elektronike si vijon:

1)info@azolab.com.tr

Në përgjigje të kërkesave të AK, rezultoi se laborator AZOLAB test raportet e të cilit janë paraqitur nga ofertuesi “Arisa Konfeksion” shpk, nuk ktheu përgjigje edhe pas kujtesës që ju bë më datë 11/12/2025. Ky fakt krijon bindjen se test raportet e paraqitura nuk përmbushin kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.8 të dokumenteve të tenderit dhe dyshimin se këto dokumente nuk janë autentike.(bashkelidhur korrespondencat)

Për sa më sipër, KVO vlerëson se ofertuesi “Arisa Konfeksion” shpk, është në kushtet e parashikuara nga neni 76, pika 3, shkronja “ë” dhe për rrjedhojë oferta e paraqitur nga ky ofertues,nuk duhet të merret në konsiderate për fazat e mëtejshme te procedurës.

-oferta e OE “ARISA – KONFEKSION” shpk, me NUIS J61828068L, është kualifikuar sipas vendimit të KPP, por pas verifikimeve të bëra lidhur me përgjigjen e kërkeses të AK, rezultoi se laborator AZOLAB test raportet e të cilit janë paraqitur nga ofertuesi “Arisa Konfeksion” shpk, nuk ktheu përgjigje edhe pas kujtesës që ju bë më datë 11/12/25. Ky fakt krijon bindjen se test raportet e paraqitura nuk përmbushin kërkesën për kualifikim sipas pikës 2.3.8,të dokumenteve të tenderit dhe dyshimin se këto dokumente nuk janë autentike. Operatori ekonomik nuk merret në konsideratë për vazhdimin e procedurës për shkak të mos paraqitjes së përgjigjes së kerkuar. - Faza: Vleresim Teknik

Ofertuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.2 duke qënë se dokumenti i paraqitur nga ana e tyre Autorizimi i Prodhuesit Portwest, nuk është lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor

Gjitashtu ofertuesi “Arisa Confecions” skualifikohet pasi nuk përmbush pikën 2.3.2 “Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë prodhues apo tregtues të autorizuar nga prodhuesit për artikujt objekt prokurimi.

Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre.

Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga

prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëebsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor”

Me date 28.08.2025 me anë të emailit të paraqitur në adresën zyrtare të prokurimeve të institucionit Illyrian Guard sha, me subjekt “Tërheqje e autorizimit të distributorit” subjekti “Extrabis” shpk është tërhequr nga dhënia e autorizimit subjektit “Arisa ConfecSION”.

Mungesa e autorizimit të prodhuesit të lartëpërmendur të lëshuar për ofertuesin Arisa e bën të pavlefshëm prodhimin e artikullit mushama shiu.

Sa më sipër ofertuesi skualifikohet.

- Oferuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.8 duke qënë se dokumenti i paraqitur prej tij në pëmbushje të kësaj pike konkretisht për produktin Triko, Kapele, Xhakovento, Këmishë me mëngë të shkurtra, Këmishë me mëngë të gjata, Pantallona Taktike, dokumente të lëshuar nga ana e vetë oferuesit “Arisa Konfeksion shpk”, dokument i cili në vetevete nuk është Certifikatë përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën të përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë
- Oferuesi skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.9, duke qënë se dokumenti i paraqitur në sistemin elektronik të APP-së, skedë teknike e lëshuar nga prodhuesi Portwest për produktin Musha Shiu, ku distributori i cili ka paraqitur autorizimin e prodhuesit ka tërhequr Autorizimin e Prodhuesit të Portwest të lëshuar për ofertuesin Arisa duke e bërë nul efektin e kësaj skede teknike përsa kohë prodhuesi është tërhequr. - Faza: Vleresim financiar

2.BOE “Univers Promotion” shpk-Malbertex sh.p.k me NIPT:K81324039M & NIPT: K71821009N

Vlera (98,430,000 Nentedhjete e tete milion e katerqind e tridhjete mije leke pa TVSH)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Arsyet e Skualifikimit:

Ne baze te vendimit nr.1702/2025 te KPP me nr prot,2645/11, date 18.11.2025
Prot me tonen me nr,187/101, date 21.11.2025 - Faza: Kriter i pergjithshem

Sipas rivlersimit date 30.12.2025 me nr prot 187/112 -oferta e BOE “MALBERTEX” shpk, dhe “UNIVERS PROMOTIONS” shpk është e kualifikuar sipas vendimit të KPP, por si AK mendojme se si ofertë anomalisht e ulët që nuk krijon bindjen se është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Materialin e argumentuar e gjeni ne procesverbalin fizik - Faza: Vleresim Teknik

- BOE "Malbertex + Univers Promotion skualifikohet pasi në ofertë duhet të përcaktonte pjesën e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejnë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. Ndërkohë në dokumentin e shkarkuar nga sistemi elektronik i APP-së të emërtuar "Marveshje_bashkepunimi (1).pdf" nuk është përcaktuar asnjë nga pjesët e shërbimit, punës dhe furnizimit kjo në kundërshtim me nenin 88 të VKM-së 285 datë 29.12.2021.

Gjithashtu në dokumentin e shkarkuar nga sistemi elektronik i APP-së të emërtuar "Marveshje_bashkepunimi (1).pdf" citohet se:

, duke përcaktuar ndër të tjera edhe "prodhimin" kjo në kundërshtim me dokumentin "Deklarate" ku përcakton se:

Sipas përmbajtjes së lartpërmendur asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve nuk do jenë prodhues të mallit objekt kontrate por thjeshtë tregtarë të mallit.

- Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi anëtar i BOE "Univers Promotion" shpik nuk përmbush pikën 1 (a) të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi formulari i përmbledhës i vetëdeklarimit nuk është mbushur në mënyrë të plotë duke mos dhënë informacionin e kërkuar, konkretisht ofertuesi nuk ka plotësuar, në lidhje me punëtorinë, duke mos përcaktuar emrin e punonjësit si dhe profilin e tij sipas marrëveshjes së bashkëpunimit duke krijuar paqartësi në përcaktimin e profilit të punonjësit që do të mbulojë gjatë ekzekutimit të kontratës.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.2 duke qënë se dokumenti i paraqitur nga ana e tyre Autorizimi i Prodhuesit, nuk është lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.4 duke qënë se në asnjë nga dokumentet e paraqitura nga ana e tyre (shtojcën 9) nuk është deklaruar se kush do jetë modelist dhe cili nga anëtarët e BOE do e përmbushë këtë pike.
- Bashkimi i Operatorëve ekonomike skualifikohet pasi nuk plotëson pikën 2.3.8 duke qënë se dokumenti i paraqitur prej tyre në përmbushje të kësaj pike, dokument i lëshuar nga ana e prodhuesit "KINGLONG PROTECTIVE PRODUCTS(HUBEI) CO., LTD", dokument i cili në veteve nuk është Certifikatë përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën të përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë - Faza: Vlerësim financiar

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Vojsava Zenelaj P.F., Tiranë, Bulevardi Gjergj Fishta, Kulla Nr.2, kati i dytë], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 138,720,000 (*Njëqind e tridhjetë e tete milion e shtatëqind e njetzet mijë leke pa TVSH*) është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

